



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.37/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazic dhe Adnan Konushevci anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterve në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijedyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografimin e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 01.06.2017, në Rrugën “Fan Noli”, në Ferizaj, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), të ngjitur në shtyllë publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), të datës 03.06.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se një person nën moshën 18 vjeçare pa leje të subjektit politik PAI-së, ka vendosur posterin e kandidatit Florim Bajramit dhe se PAI pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një foto nga vendi ku është larguar posterin. PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PAI, janë vendosur në shtyllë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) janë vendosur në shtyllë publike të qytetit. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik PAI, në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky subjekt politik është vendosur në shtyllë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjekti politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 37/2017 më datën 06.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.